

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

Referuar informacionit të vënë dispozicion për Njësinë e Ankandit nga autoriteti Shtetë, rezulton:

-Procedura për privatizimin e Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a, është iniciuar në muajin Janar të vitit 2017 me hapin e parë vleresimitin e aseteve të shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a i nëpërmjet një procesi transparent nga subjekte të licencuar.

Raporti i vleresimit të aseteve të shoqërisë, rezulton i publikuar në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër :[raport vlersimi vllaznia 1640.pdf \(bashkiashkoder.gov.al\)](#).

I gjithë procesi për shitjen e aksioneve të shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia i është nënshtruar një procedurë të gjere për konsultimin dhe këshillimin me publikun në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" e publikuar në çdo hap në ballinën e faqes së internetit të Bashkisë Shkodër, në web linkun [Ecuria e procedurës për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a në masën 100% \(bashkiashkoder.gov.al\)](#)

Këshilli Bashkiak Shkodër me vendimin nr.54 i datë 27.11.2020 "Për miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të Futbollit "Vllaznia" SH.A. në masën 100%", Këshilli Bashkiak ka vendosur:

- *Miratimin për shpalljen për shitje të 100% të aksioneve që Bashkia Shkodër zotorën si aksionere e vetme në shoqërinë Klubi i Futbollit "Vllaznia"*
- *Çmimi minimal i shitjes së 100% të kuotave është 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) lekë*
- *Forma e shitjes së aksioneve që zotërohet nga Bashkia Shkodër në Shoqërinë Klubi i Futbollit "Vllaznia", të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedurë e Hapur Standart e Ankandit, sipas dokumentave standarte tip të ankandit, bashkëngjitur këtij vendimi:*

dokument i publikuar në ballinën e faqes së internetit të Bashkisë Shkodër web linkun [Ecuria e procedurës për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a në masën 100% \(bashkiashkoder.gov.al\)](#).

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

Njësia e Ankandit në zbatim të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, dokumentave standart të ankandit (DSA) dhe sigurisht referuar objektit të ankandit, ka miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit, për ankandin publik me objekt : *Shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a në masën 100%.*

Legjislacioni i zbatueshëm:

- Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar
- VKM nr. 1719, datë 17.12.2008“Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji 79/2017 “ Për Sportin”, i ndryshuar
- Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar

Njësia e Ankandit vlerëson se: Kriteret e veçanta për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit shitës për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës. Sipas specifikave që ka ky Ankand Pulik dhe aktivitetit të shoqërisë tregtare “Klubi i Futbollit Vllaznia” sha, (*referuar informacionit dhe specifikimeve teknike të vena në dispozicion nga autoriteti Shitës*) me qëllim që të krijohet bindja apo siguria e përmbushjes së objektivave teknike, financiare dhe sportive, nga subjektet kandidatë ofertues/blerws, kemi përcaktuar kërkesat të veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për





ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

t'u përmbushur nga subjektet e interesuara në këtë procedurë ankandi, në mënyrë që të garantohet vazhdimësia, qëndrueshmëria, efikasiteti dhe përmbushja e objektivave sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a edhe në vijim pas procesit të privatizimit.

Vlen të theksohet se ligji i posacëm për ankandet publike nuk parashikon asnjë dispozitë me anë të së cilës kufizon autoritet shitëse të përcaktojnë kriteret e veçanta të kualifikimit, që gjykojnë se janë të nevojshme për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës, për sa kohë këto kriteret nuk tejkalojnë objektin dhe volumnin e saj, praktikë kjo e konsoliduar edhe nëpërmjet Vendimeve të Komisionerit të Prokurimeve Publike. *(referohemi në kushtet ku ky institucion është organ kompetent sipas ligjit për shqyrtimin e vendimmarrjes së autoriteteve shitëse në procedurë ankandit).*

Në rastin konkret njësia e ankandit, kërkon të krijojë panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës, mbi përvojën e mëparshme të kandidatëve blerës, në mënyrë që të krijojë bindjen se këta të fundit posedojnë eksperiencën e duhur për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandi, kanë mjetet e nevojshme financiare, kapacitetet njerezore si dhe eksperiencën e duhur në menaxhimin e aktiviteteve sportive.

Kriteret e veçanta për kualifikimi të miratuara nga njësia e ankandit, janë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të kandidatëve blerës, natyrën dhe vlerën e kontratës.

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



KRITERET E PERCAKTUARA	ARSYETIMI	MBESHTETJA LIGJORE
a) Të jetë person juridik (shoqëri tregtare) për më shumë se tre vite nga data e hapjes së ankandit, vërtetuar me Ekstraktin Historik të lëshuar nga QKB dhe me kopje të noterizuar të Çertifikatës së Regjistrimit NIPT.	<p>Kandidatët blerës që përmbushin këto kritere krijojnë besueshmeri dhe garantojnë vazhdimësinë, efikasitetin dhe përmbushjen objektivave sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia edhe në vijim pas procesit të privatizimit.</p> <p>Subjekte sipas ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar Përcaktuar si periudhë minimale periudhën e fundit tre vjecare (afat i përdorur në harmoni me të gjitha kriteret vijuese) për të krijuar bindjen e tij që subjektet tregtare kanë eksperiencë në menaxhimin e aktiviteteve sportive në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Sigurisht që nuk përjashtohen subjektet të cilat kësaj eksperiencë i kanë të konsoliduara edhe nga vitet e mëparshme.</p> <p>Kriteri për të qenë person juridik (shoqëri tregtare) është bërë duke ju referuar edhe frymës së projektligjit të Hartuar nga Këshilli i Ministrave ku përcaktohet se:</p> <p>“Nga 51% deri në 100% të aksioneve/kuotave të kapitalit u ofrohen investitorëve të interesuar, të cilët mund të jenë shoqëri apo bashkim</p>	<p>Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Përmiratimin e rregullavetë ankandit publik”, indryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3, dhe parashikimet e bëra në DSA standard.</p>



ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

	shoqërisht, që zotërojnë garancitë e nevojshme financiare për zbatimin e projektit të investimit të paraqitur. Çmimi i privatizimit paguhet për llogari të shitësit.” ¹	
b) Te tregojë me shifra dhe pasqyra financiare ecurinë pozitive në menaxhimin e aktivitetit ekonomik dhe tregtar. Të mos ketë rezultuar me humbje në tre vitet e fundit, vërtetuar me kopje të noterizuara të Pasqyrave Financiare për tre vitet e fundit, të konfirmuara nga Drejtoria Tatimore.	<p>Kandidatët blerës që përmbushin këto kritere krijojnë besueshmeri në përmbushjen objektivave financiare sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia edhe në vijim pas procesit të privatizimit.</p> <p>Me qëllim që të provohen kapacitetet dhe mundësitë financiare të kandidatit blerës për përmbushjen me sukses të kontratës,</p> <p>Në cilësinë e subjekteve tregtare ky kriter është vendosur përputhje me ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</p> <p>Përcaktuar si periudhë “tre vitet e fundit “ (<i>afat i perdorur në harmoni me të gjitha kriteret vijuese , në analogji dhe me kriteret që kërkohen për realizimin e kontratave në zbatim të ligjit “Për</i></p>	Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, indryshuar , kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standard

¹ Lexo “Relacion per projektligjin “Për Përcaktimin e formës te Procedures e te formules se privatizimit te klubeve sportive”, fq 3 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200226132735Relacioni%20Klubet%20sportive.pdf>

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njësisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



	<i>Prokurimin Publik</i> ”) për të krijuar bindjen e tij që kandidatët blerës, disponojnë mjetet e nevojshme financiare, me qëllim që të provohen kapacitetet dhe mundësitë e kandidatit blerës për përmbushjen me sukses të kontratës.	
c) Vërtetim/e nga Banka/at për gjendjen e mjeteve monetare. Të ketë aktive likuide (mjetemonetare) jo më pak se vlera fillestare e ankandit, të vërtetuar me konfirmime zyrtare nga Bankat, për një date jo më të hershme se 5 ditë kalendarike nga data e hapjes së ofertave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës që provon burimin e këtyre mjeteve monetare.	Kriter i miratuar me qëllim që të provohen kapacitetet dhe mundësitë financiare të kandidatit blerës për përmbushjen me sukses të kontratës.	Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6 pika 1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, i ndryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standart.
d) Vërtetim të lëshuar nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore shtetërore me date jo më të hershme se tre muaj nga data e hapjes së ofertave.	Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje me detyrimet ligjore dhe konkretisht në zbatim të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar , ligjit Nr.	Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6 pika 1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “ Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, i ndryshuar , kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standard (shtojca 6)



ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

	8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar	
e) Vërtetim të lëshuar nga Bashkia ku ushtron aktivitetin dhe ka selinë ofertuesi/it për shlyerjen e taksave vendore.	Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje me detyrimet ligjore dhe konkretisht në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar	Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6 pika1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “ Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, indryshuar , kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standart(shtojca 6)
f) Vërtetimin se ofertuesi/it nuk është /janë i/ të dënuar me vendim gjykate të forms së prerë, për vepra penale që lidhen me tatim-taksat dhe sigurimet shoqërore;	Duke qene se sporti konsiderohet nje e mire publike dhe ne rastin konkret eshte e domosdoshme qe ofertuesit te mos kene rekorde kriminale te cilat cenojne besimin e publikut eshte konsideruar i domosdoshem nje kriter i tille. Po ashty ky kriter eshte miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje me detyrimet ligjore dhe konkretisht në zbatim të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqiperise” i ndryshuar , ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i	Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6 pika1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, indryshuar , kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standard (shtojca 6)

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njësisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



	<p>ndryshuar , ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar , me qëllimin final që kandidatit blerës të përmbush kërkesat e ligjore për përmbushjen me sukses të kontratës.</p> <p>Kriter i cili është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA .</p>	
g) Vërtetimin se ofertuesi/it që subjekti nuk është pezulluar me vendim gjykatë.	<p>Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës rezulton me statusin AKTIV në veprimtarinë tregtare.</p> <p>Kriter i cili është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA.</p>	<p>Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “ Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, I ndryshuar , kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standart (shtojca 6)</p>
h) Deklaratë të subjektit/eve mbi konfliktin e interesave.	<p>Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës nuk është në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, neni 15; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Për miratimin e</p>	<p>Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, neni 15; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Për miratimin e rregullavetëankanditpublik”, indryshuar, kreu V, pika 5.2.</p>



ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

	rregullavetëankanditpublik”, indryshuar, kreu V, pika 5.2.	
i) Formular për sigurimin e ofertës.	Kriter i parashikuar nga ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, neni 32; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, I ndryshuar, kreu III, pika 3.3.1 germa e)	Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, neni 32; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, I ndryshuar, kreu III, pika 3.3.1 germa e), DSA standart (shtojca 4.)
j) Deklaratë që subjekti/et 1. nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv), 2. Që aktiviteti i subjektit/eve nuk është marrë nën administrimin e ndonjë gjykate. 3. Që nuk është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme.	Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që, kandidatët blerës rezultojnë me statusin AKTIV në veprimtarinë tregtare, qkb. Kanë kapacitetin, aftësinë ligjore, financiare, menaxhuese për të zhvilluar aktivitetet ekonomik tregtar aktiv, pra nuk gjendet në ndonjërin nga kushtet e parashikuara në pikat 1,2,3 të germës j) Kriter i cili është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA.	Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6 pika 1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, I ndryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standart (shtojca 6)
k) Deklaratë që subjekti/tet nuk është dënuar për një krim të rëndë, përfshirë veprën penale të parashikuar nga neni	Duke qene se sporti konsiderohet nje e mire publike dhe ne rastin konkret eshte e domosdoshme qe ofertuesit te mos kene rekorde kriminale te cilat	Statuti i FSHF, Rregullorja e Liçensimit te Klubeve për

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



<p>197/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, ose të jetë rehabilituar sipas legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë si dhe të mos jetë i dënuar për trukim ndeshjesh nga organet e FIFA, UEFA ose FSHF.</p>	<p>cenojne besimin e publikut eshte konsideruar I domosdoshem nje kriter I tille. Prandaj ky Kriter eshte miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje me detyrimet ligjore penale në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe parashikimet e Statutit të FSHF</p>	<p>pjesëmarrje në UEFA shkresë nr. 53 prot, datë 11.02.2021.</p>
<p>l) Deklaratë qësubjekti/etgaranton që mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë subjekt i jashtëm dhe të sigurojë që çështjet e tij të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në veçanti që ai është i pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm.</p>	<p>Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet besueshmeri që kandidatët blerës garantojnë vazhdimësinë , efiçensën dhe permbushjen objektivave sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia edhe në vijim pas procesit të privatizimit, në mënyrë të pavarur pa ndërhyrje apo ndikime politike të papërshtatshme</p>	<p>Statuti FSHF + Shkresa me nr. 53 prot., dt. 11.01.2021 e derguar nga Statuti i FSHF, Rregullorja e Liçensimit te Klubeve për pjesëmarrje në UEFA shkresë nr. 53 prot, datë 11.02.2021.</p>
<p>m) Deklaratë qësubjekti/tet nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje lidhur me sjelljen profesionale;</p>	<p>Duke qene se sporti konsiderohet nje e mire publike dhe ne rastin konkret eshte e domosdoshme qe ofertuesit te mos kene rekorde kriminale te cilat cenojne besimin e publikut eshte konsideruar i domosdoshem nje kriter i tille. Kriteri eshte miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet</p>	<p>Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6 pika1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, date 17.12.2008 “ Përmiratimin e rregullavetëankanditpublik”, I</p>



ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

	<p>bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje me detyrimet ligjore përkatëse profesionale.</p> <p>Kriter i cili është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA.</p>	<p>ndryshuar , kreu III, pika 3, pika 3.3, DSA standart(shtojca 6)</p>
<p>n) Deklaratë qësubjekti/tet nuk është nuk është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruara në nenin 15 të Ligjit të Ankandit Publik (LAP);</p>	<p>Duke qene se sporti konsiderohet nje e mire publike dhe ne rastin konkret eshte e domosdoshme qe ofertuesit te mos kene rekorde kriminale te cilat cenojne besimin e publikut eshte konsideruar i domosdoshem nje kriter i tille. Kriteri eshte miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje detyrimet ligjore dhe nuk është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruara në nenin 15 i Ligjit të Ankandit Publik (LAP);</p> <p>Kriter i cili është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA.</p>	<p>Neni 15 i Ligjit të Ankandit Publik (LAP); dhe DSA standart(shtojca 6)</p>
<p>o) Deklaratë qësubjekti/tet nuk është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikën korruptive, pastrimin e parave,</p>	<p>Duke qene se sporti konsiderohet nje e mire publike dhe ne rastin konkret eshte e domosdoshme qe ofertuesit te mos kene rekorde kriminale te cilat cenojne besimin e publikut eshte konsideruar i domosdoshem nje kriter i tille. Ky kriter eshte</p>	<p>Neni 15 i Ligjit të Ankandit Publik (LAP); DSA standart (shtojca 6)</p>

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



<p>organizimin kriminal ose aktivitetet e përshkruara në Nenin 15 të LAP, në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;</p>	<p>miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje detyrimet ligjore dhe nuk është gjykuar se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikat korruptive, pastrimin e parave, organizimin kriminal ose aktivitetet e përshkruara në Nenin 15 të LAP, në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare);</p> <p>Kriter i cili është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA .</p>	
<p>p) Deklaratë që nuk është dënuar nga një gjykatë me juridiksion kompetent se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;</p>	<p>Duke qene se sporti konsiderohet nje e mire publike dhe ne rastin konkret eshte e domosdoshme qe ofertuesit te mos kene rekorde kriminale te cilat cenojne besimin e publikut eshte konsideruar i domosdoshem nje kriter i tille. Ky kriter eshte miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatit blerës ushtron veprimtarinë tregtare në përputhje detyrimet ligjore dhe nuk është dënuar nga një gjykatë me juridiksion kompetent se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin; Kriter i cili</p>	<p>Neni 15 i Ligjit të Ankandit Publik (LAP); DSA standart (shtojca 6)</p>



ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)

	është i parashikuar si shkak skualifikimi dhe nga shojca 6 e DSA .	
q) Kontrata, transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe për sporte të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit, pjese te veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.	<p>Kriter i miratuar me qëllim që të krijohet bindja, besueshmëria që kandidatët blerës posedojnë përvojën e mëparshme në drejtim të financimit-sponsorizimit, bashkëpunimit ose menaxhimit të klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit, apo edhe për sportet e tjera të ngjashme ekipore , me qëllim për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandi.</p> <p>Përcaktuar si periudhë minimalisht në tre vitet e fundit (afat i përdorur në harmoni me të gjitha kriteret e tjera) për të krijuar bindjen që subjektet tregtare kanë eksperiencia në menaxhimin e aktiviteteve sportive në menyre të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Sigurisht që nuk përjashtohen subjektet të cilat keto eksperiencia i kanë të konsoliduara edhe nga vitet e mëparshme.</p> <p>Ne përcaktimin e këtij kriterit Njesia e Ankandit është orientuar edhe konkretisht në Vendimin 752/2017 të Komisionit të Prokurimeve Publike i cili në arsyetimin e vendimit të tij ka përcaktuar se:</p>	<p>Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Përmiratimin e rregullave të ankandit publik”, indryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3. Vendimin me nr. 752/2017 të Komisionit të Prokurimeve Publike</p>

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



	<i>“.....lidhur me vlerën e që duhet te kenë kontratat e së njëjtës natyre, KPP gjykon se përcaktimi i një vlere të caktuar i shërben autoritetit shitës të krijoj bindjen mbi aftësinë e kandidatëve blerës për përmbushjen e kontratës sipas volumit të saj.”</i>	
r) Te paraqesë nje plan biznes të detajuar me të gjitha elementet e një plan biznesi, shoqëruar me dokumentacionin përbërës, për aktivitetet për periudhën afatmesme, duke u angazhuar me deklaratëse do të investojë sipas këtij plani për të rritur rezultatet sportive dhe ekonomike të shoqërisë.	Kandidatët blerës nepërmjet përmushjes së këtij kriteri vlerësojmë se krijojnë bindjen e duhur, i krijojnë besueshmeri autoritetit shitës se këta të fundit posedojnë eksperiencën e duhur për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandi, kanë mjetet e nevojshme financiare, kapacitetet njerezore si dhe eksperiencën e duhur në menaxhimin e aktiviteve sportive. Me qëllim që të garantohet vazhdimësia, qëndrueshmëria, efijçensa dhe përmbushja e objektivave sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a edhe në vijim pas procesit të privatizimit.	Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, indryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3,
s) Për të vërtetuar se ka kapacitetet njerezore profesionale të mjaftueshme për të realizuar planin e biznesit, subjekti/tet duhet të paraqesë listën e stafit që do të angazhojë. Për secilin/ën anëtar/e të stafit që do të angazhohet duhet të paraqesë CV përkatëse dhe	Kriter i miratuar me qëllim që të provohet, të krijohet bindja që kandidatët blerës posedojnë kapacitetet njerezore dhe eksperiencën e duhur në menaxhimin e aktiviteve sportive, me qëllim për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandi.	Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”,

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



<p>deklaratën e angazhimit të nënshkruar personalisht.</p>		<p>indryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3</p>
<p>t) Deklaratë që subjekti/subjektet ofertues nuk është ortak, i angazhuar për një klub tjetër futbollit, anëtar i federatës shqiptare të futbollit, pasi kjo dëmton konkurrencën sipas ligjit, në ligën shqiptare të futbollit.</p>	<p>Kriter i miratuar me qëllim që të krijohet besueshmëria që kandidatit blerës do ketë fokus në fushën e veprimtarisë Sportive Klubin e Futbollit Vllaznia dhe jo të jetë ortak një klub tjetër futbollit, anëtar i federatës shqiptare të futbollit, me qëllimin që të garantohet vazhdimësia, qëndrueshmëria, efijensa dhe përmbushja e objektivave sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a edhe në vijim pas procesit të privatizimit.</p>	<p>Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008“Pë rmiratimin e rregullave të ankandit publik”, indryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3.</p>
<p>u) Sponsorizime të ngjashme në një vlerë prej 20,317,600 lekë (40% e vlerës fillestare te ankandit), të realizuara.Çdo sponsorizim rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit. Kryerja e çdo sponsorizimi, në para a në natyrë, dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme subjekti/tet të paraqesë dokumenta që vertetojnë:</p>	<p>Kriter i miratuar me qëllim që të krijohet bindja, besueshmëria që kandidatët blerës posedojnë përvojën e mëparshme në drejtim të financimit-sponsorizimit, bashkëpunimit ose menaxhimit të klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit, apo edhe për sportet e tjera të ngjashme ekipore , me qëllim për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandi.</p> <p>Dokumentacioni i kërkuar në përputhje me parashikimet e ligjit “Për sportin” 79/2017, i ndryshuar, ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, indryshuar, si dhe ligjit nr.9920,</p>	<p>Ligji nr. 9874, date 14.2.2008 “Për Ankandin Publik”, nenet 6/1, 9, 29 dhe 30; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, I ndryshuar, kreu III, pika 3, pika 3.3,</p> <p>Neni 4, Ligji Nr.7892, datë 21.12.1994,“Për sponsorizimet” i ndryshuar</p> <p>Kriter i miratuar dhe në përputhje me parashikimet e ligjit “Për sportin” 79/2017, i ndryshuar,</p>

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



<p>Sponsorizimet në favor të sporteve ekipore më të përhapura, të destinuara për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.evidentimin e talenteve dhe zhvillimin e sportistëve të rinj; 2.mbulimin e shpenzimeve të stafit sportiv; 3.përmirësimin dhe rinovimin e pasurive të luajtshme që i shërbejnë për aktivitetin sportiv; 4.zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive; 5.shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimin; ose 6.mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive. <p>Dokumentat që vërtetojnë transferimin e shumës së sponsorizimit, do të jenë, aktmarrëveshje, vendime të këshillit bashkiak për donacione apo sponsorizime, dokumente bankare që vërtetojnë transferimin e shumave, fatura tatimore, akte dhurimi, proces verbale marrje në</p>	<p>datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Ne percaktimin e këtij kriterit ne lidhje me sponsorizimet e ngjashme Njesia e Ankandit është orientuar edhe konkretisht ne Vendimin 752/2017 te Komisionit te Prokurimeve Publike i cili ne arsyetimin e vendimit te tij ka percaktuar se:</p> <p>“.....është në të drejtën e vetë autoritetit shitës që të përcaktojë vlerën që duhet të kenë kontratat e të njëjtës natyre dhe caktimi prej këtij të fundit se vlera tyre duhet të jetë e barabartë me vlerën fillestare të objektit të shitjes nuk e tejkalon volumin e kontratës e për pasojë ky kriter i vendosur nga autoriteti shitës nuk mund të konsiderohet si i papajtueshëm me të.”</p> <p>Persa i takon vleres se sponsorizimeve ne masen 40% te vleres fillestare te ankandit, ne percaktimin e këtij kriteri është marre ne konsiderate dhe percaktimi i bere ne nenin 28, pika 3 dhe 4/b, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet përkatësisht se: <i>”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon</i></p>	<p>Dokumentacioni i kërkuar në përputhje me parashikimet e ligjit “Për sportin” 79/2017, i ndryshuar, ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, indryshuar, si dhe ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Neni 48, pika 3, neni 57, ligji nr. 9920, date 19.5.2008, “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”, I ndryshuar.</p>
--	---	--

ANEKS 1

(Pjesë e përbërëse e Procesverbalit të Njesisë së Ankandit për DSA e miratuar)

ANALIZA/MBESHTETJA LIGJORE E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Shtojca 5 pika 2)



<p>dorëzim, fletë hyrje, etj dokumenta që parashikohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë tatimor kontabël e bankar në fuqi.</p>	<p><i>dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.”</i></p>	
<p>Në rastin kur oferta mund të paraqitet nga një grup kandidatësh bleres, kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në germat: d, e, f , g, h, j deri tek p, dhe t duhet të plotësohen nga secili prej kandidatëve pjesë e grupit.</p>		<p>Dokunetet Standart te Ankandit</p>
<p>Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose dorëzimit të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.</p>		

